



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAM

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: METODIKA E FORMIMIT TË KONCEPTEVE NË GJEOGRAFINË FIZIKE

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Vasil TROJANI
<i>Ngarkesa:</i>	7 ETCS (2 leksione dhe 2 seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Programi i studimit:</i>	Master Profesional në Gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Shkurtesë: Metodika e formimit të koncepteve të gjeografisë fizike ka për pikësynim të japi rrugët dhe metodikë për përvetësimin e koncepteve bazë gjeografike në mënyrë të qëndrueshme dhe të mësojë aplikimin e tyre në mënyrë të pavarur në situata të ndryshme. Ndryshe nga aplikimi i të mësuarit mekanik synohet një përvetësim i ndërgjegjshëm dhe aktiv tek nxënësit.

Temat e leksioneve:

1. Përcaktimi i saktë i objektit të studimit e detyrave dhe aplikimet të gjeografisë fizike. Aplikimi i saj në ndihmë të zhvillimit ekonomik e mjedisor të territoreve gjeografike.
2. Metodatat që i shërbejnë formimit të koncepteve të gjeografisë fizike. Metodatat gjeofizike, gjeokimike, matematike, hartografike, të krahasimit, vrojtimit eksperimental etj.
3. Përdorimi i metodave të ndryshme për formimin e koncepteve gjeosistem, mbështjellje gjeografike, mjedis gjeografik, sistem diellor, planete, komete, asteroide, meteore dhe roli i tyre në sipërfaqen e Tokës.
4. Koncepti i rrotullimit rreth vehtes dhe rreth diellit nëpërmjet metodës eksperimentale. Përdorimi i metodave matematikoretë të performuar konceptin e forcës së Koriolisit të lëvizjes së trupave dhe shpjegimi i dukurive atmosferike, hidrologjike e trupave të ngurta gjatë lëvizjes së tyre në gjerësi të ndryshme gjeografike. Koncepti brezat e kohës dhe aplikimi i tyre në situata të ndryshme. Aplikimet konkret e përcaktimi i tyre.
5. Koncepti mbi vecoritë fizike të Tokës (vecoritë termike, densiteti, trysnia, gjeograviteti, magnetizmi, akustika tokësore, optika tokësore. Rrugët metodike për formimin e tyre dhe aplikimi përkatës. Konceptet moshë relative dhe moshë absolute. Rrugët për përcaktimin saktë të tyre. Ushtrime për përcaktimin e tyre nëpërmjet krahasimit biotike dhe metodës së karbonit .
6. Koncepti plan, plan topografik, hartë dhe rrugët metodike për kalimin nga një konceptim tek tjetri. Aplikimi i tyre nëpërmjet ushtrimeve, diktohet topografik, matjeve të distancave, pjerrësive, orientimit, krahasimit deri tek projeksionet dhe krahasimittë hartave për të dhënë rolin e predominantit të zonalitetit. Përdorimi i punëve praktike për përcaktimin e kohës lokale, i gjatësisë, gjerësisë gjeografike.
7. Koncepti mbi atmosferën e tokës. Përbërja struktura e saj. Krahasimi me trupat e tjerë qiellorë të planetev të tjera. Evolucionin e atmosferës tokësore e ndikimi antropogjen. Energjia në gjeosistem. Përcaktimi i shpërndarjes së energjisë në rruzullin tokësor sipas gjerësisë gjeografike dhe lartësisë. Ushtrime praktike për të përcaktuar sasinë e energjisë së rrezeve diellore. Eksperimente për të kuptuar efektin serë. Eksperiment mbi ndryshimin e temperaturës së ajrit në funksion të sipërfaqeve të ndryshme tokësore. Eksperiment mbi procesin e avullimit në sipërfaqe të ndryshme të rruzullit tokësor (uji, bimësi, akull, zona maolare, gropa ndërmaolare, fusha etj.

8. Lagështia e ajrit. Koncepti lagështirë relative, lagështirë absolute, lagështirë specifike. Eksperimenti me sfungjer për përcaktimin e lagështirës relative në varësi të temperaturës dhe të ardhjes së avujve të ujit.
9. Format e kondensimit: retë, mjegulla, reshjet, thatësira, etj. Ndryshimi i sasisë së tyre në funksion të kushteve fiziko-gjeografike në rruzullin tokësor. Analiza e grafikëve të tyre. Trysnia atmosferike endryshimi i saj në hapësirë dhe në kohë. Zonat e trysnisë atmosferike në rruzullin tokësor. Roli i rrezatimit diellordhe i njollave diellore në shpërndarjen e qendrave të përhershme dhe sezonale barike. Analiza e hartave barike në rruzullin tokësor për përcaktimin e llojeve të tyre. Analiza grafike. Roli i tyre në klimë..
10. Faktorët që ndikojnë në formimin e erës. Ndërtimi i trëndafilut të erës dhe analiza e tij. Si shprehet veprimi i erës në gjeosistem. Si influencon era në veprimtarinë e njeriut. Llojet e erërave (të qarkullimit të përgjithshëm, tornadot, erërat lokale. Eksperimente mbi formimin e erës, si ndikojnë komponentet e peizazhit në veprimtarinë e erës. Shembuj konkretë. Përse erërat në hemisferën veriore e jugore shmangen nga drejtime i lëvizjes majtas në hemisferën jugore e djathtas në hemisferën veriore. Në cilat gjerësi shmangia është më e madhe? Pse? .
11. Koncepti “Klimë” dhe “Moti”. Faktorët që ndikojnë në to. Analiza e hartave klimatike për të përcaktuar klima të ndryshme sipas zonalitetit horizontal për detyrimet e tyre duke përcaktuar faktorët që ndikojnë dhe sipas zonalitetit horizontal për detyrimet e tyre duke përcaktuar faktorët që ndikojnë dhe sipas zonalitetit për devijimet e tyre duke përcaktuar faktorët që ndikojnë dhe sipas zonalitetit vertikal (harta e vendit tonë) duke përcaktuar korelacionet në mes tyre. Koncepti “ndryshim” dhe “luhatje të klimës”. Përcaktimi i dëshmimeve të komponentëve të ndryshëm të gjeosistemit. Argumentat për ngrohjen e klimës në ditët e sotme. Puna me hartat sinoptike.
12. Si realizohet qarkullimi i ujit në natyrë sipas komponentëve. Dinamika e ujërave detare dhe oqeanike. Ujërat kontinentale. Organizimi i punëve praktike për kapitullin e hidrologjisë për formimin dhe aplikimin e koncepteve bazë.
13. Formimi i koncepteve bazë të biosferës nëpërmjet analizës së figurave e skemave dhe aplikimi i tyre me anën e punëve praktike. Ekosistem, biomasë, biocenozë, zinxhiri i ushqimit etj.
14. Zonat natyrore të rruzullit tokësor. Ndryshimi mbi bazën e faktorëve që ndikojnë. Vlerësimi i potencialit natyror dhe i risqeve përkatëse nëpërmjet vrojtimit të veçantë të tyre (shkaqet e pabarazisë së zhvillimit; gjendja e zonave bregdetare; problemet mjedisore; problemet e energjisë..
15. Ligjet e gjeosistemit, rëndësia teorike dhe praktike e tyre nëpërmjet analizave e punëve praktike.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi 100 % të seminareve	10% e notës
- Angazhimi në seminare	10% e notës
- Detyra e kursit	10% e notës
- Testet	10% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	60% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. Trojani V., *Gjeografia fizike e përgjithshme*, Tiranë 2004.
2. Trojani V., *Gjeografia fizike e përgjithshme, Ushtrime dhe aplikime*, Tiranë 2004
3. Trojani V., *Metodika e formimit të koncepteve të gjeografisë fizike për klasën e VI*. Dorëshkrim.
4. Trojani V., *Metodika e formimit të koncepteve të gjeografisë fizike në shkollë. Cikël leksionesh pasuniversitare.*

MIRATOI
Përgjegjësi i Departamentit
Prof. dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016